



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE
DREJTORIA JURIDIKE
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ prot.

Vlorë, më ____ . ____ .2026

PROCES VERBAL-Tipi i kontratës – e hapur Pune

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE
TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**
*(Ky procesverbal është përfekt publikimi bashkë me dokumentet e
tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi

Fondi Limit: 78,677,500 (Shtatedhjetë e tetemilion e gjashtëqind e shtatedhjetë e shtatemije e peseqind) Leke pa TVSH

Fondi Limit: 818,874 (teteqind e tetembedhjetemije e teteqind e shtatedhjetë e kater) Euro

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: 4 muaj

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *“Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojme Neni 83 i LPP *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:** Sipas shtojcës 8 të këtyre dokumenteve.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros

për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarres te mundshem si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për keestet e maturuara te vitit 2026 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Ky kriter eshte përcaktuar bazuar ne ligjinnr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Përsistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.2.3 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore të 3 (tre) viteve të fundit (2023, 2024, 2025) të çertifikuar nga organet tatimore si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm **në një vlerë jo më të vogël** se 40% e vlerës së përllëgëruar të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, **është jo më e vogël se vlera limit** e kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i

përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore **te deklaruara ne organet tatimore** dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Argumentim Ligjor: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Argumentimi Teknik:

Do te sherbej per bilancet per te pare se ka kyer apo jo kontrate te ngjashme lidhur me punet publike te cilat ka bere. Dhe per te vertetuar seriozitetin e operatoreve ekonomike .

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në bazë të VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

Për punimet punimet në ndërtim :

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë;
- NP-4 C Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha,tramvai,metro etj;
- N.P-7 A Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje;
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit;

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **N.S-1A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S-6-A** Sinjalistika rrugore jodriçuese;
- **N.S-18-A** Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi Ligjor : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe VKM – së Nr. 42, datë 16.01.2008 ”Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit Nr. 8 402, datë 10.09.1998 ”Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, ku neni 8 përcakton ”Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimi. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Lidhur me nivelin e kategorive në licencë janë në përputhje me natyrën dhe fondin limit që prokurohet, si dhe kërkohet që operatorët ekonomikë të japin garanci që i kanë aftësitë tekniko – profesionale në nivele të kategorive për realizimin e objektit që prokurohet.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria	Pershkrimi I kategorisë	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli I klasifikimit I kërkuar për kategorinë respektive	
NP-1	Punime gërmimi në tokë.	Referuar kapitullit të gërmimeve sipas parashikimit të projekt preventivit prishje/gërmime/transport/mbushje (punime për prita, gërmime shkarkimi, mbushje, transport mbeturinash). Për këtë arsye kërkohet licenca NP-1A për të	A	

		garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.		
NP-4	Rruge,autostrada,mbikalime,hekurudha, tramvai,metro etj	Perfshin ne menyre te thjeshtuar rruget, pavaresisht nga shkalla e e tyre e rendesise, autostradat, superstradat perfshire nderhyrjet e ne pika te vecanta, tunelet, devijimet nen niparavele dhe ne lartesi, parkimet, punimet e mureve mbajtese, hekurudha, metro, hekurushe me kavo, tramvai, pista aeroportuale, sheshet e helikoptereve, sheshet e realizuara me materiale te vecanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, ne hekur, betonarme te thjeshte dhe te paranderur, parafabrikat ose te prodhuar ne object. Konsiderohen ndertimet, mirembajtjet ose rikonsturim I nderhyrjeve ne rrjetin rrugor te nevojshem per te ndjere paqendrueshmerine mbi goma, hekur, zona, kushdo qe te jete shkalla e rendesise, kompletimi I çdo vepre lidhese, plotesuese ose paisje edhe e tipit te vecante, te linjes hekurudhore. Për këtë arsye kërkohet licenca NP-4C për të garantuar që operatori ka kapacitetin teknik dhe përvojën për punime të tokës.	C	
NP-7	Ujesjelles, gazsjelles, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres se punimeve te preventivit te punimeve KUB, kullimi etj.)	A	
NP-9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike (referuar vleres se punimeve te preventivit)	A	
NP-11	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike , punimeve te cmontim linja elektrike, spostim shtylla, F.V. linja te reja, shtylla ndricimi etj.	A	
NP- 12	Punime të inxhinierisë mjedisore	Referuar punimeve te inxhinierise se mjedisit, Punime sistemimi të jashtme, , rehabilitim mjedisor .	A	
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike Referuar preventivit mbi Punimet per prishjen e ndertimeve ekzistuese rrugore, kanalizime, mure, etj	A	
NS-6	Sinjalistika rrugore jondricuese	Referuar projektit dhe specifikimeve teknike Referuar preventivit mbi Sinjalistika rrugore jondricuese	A	
NS-18	Punime topogjeodezike	Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.	A	

Kategorite e mesiperme jane kerkuar referur zerave te preventivit dhe vleres perkatese te cilat i pergjigjen klasifikimit te mesiperm.

2.3.3 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për **muajin** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

1 (nje) Inxhinier Ndertimi

1 (nje) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder/ **ose me kontrate bashkepunimi** 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik/ **ose me kontrate bashkepunimi**

1 (një) Inxhinier Mjedisi / **ose me kontrate bashkepunimi**

1 (nje) Ing. Elektrik/ **ose me kontrate bashkepunimi**

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

Argumentimi teknik se për se shërbejnë inxhinieret :

- **Inxhinier Ndertimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder / ose me kontrate bashkepunimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.
- **Inxhinieri Mjedisit / ose me kontrate bashkepunimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në licencën profesionale të shoqërisë.

Inxhinieri Elektrik / ose me kontrate bashkepunimi është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve Elektrik, referuar

punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë. **Argumentim Teknik per se duhet inxhinieri elektrik :**

- **Inxhinieri elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve per rehabilitimin e stacioneve te autobuzave urban sipas volumeve ne preventiv:
 - **Prishje te rrjetit ekzistues**
 - **Instalime ndricimi**
 - **F.v ndricues Led**

- **Inxhinieri Hidroteknik/ ose me kontrate bashkepunimi** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve Hidroteknike, referuar punimeve të parashikuara në preventiv dhe kategorisë së kërkuar në liçencën profesionale të shoqërisë.

Referuar natyrës dhe objektit të kontratës së prokurimit, shfaqet e nevojshme disponimi i stafit në nivel inxhinieri për realizimin e ketyre punimeve. Kriteri i mësipërm ne lidhje me stafin kryesor është lidhur edhe me disponueshmërinë e licencës dhe kriterëve të licencës së kërkuar. Konkretisht në Vendimin 42, date 16.01.2008 i Këshillit të Ministrave “*Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, i ndryshuar parashikohet se: “*Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas: I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në: - profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.*”

Sa më sipër, duke marre parasysh natyren e puneve te objektit te prokurimit, ka perzgjedhur stafin e drejtuesve teknik, te cilet jane te nevojshem per realizimin e punimeve duke u buzar ne natyren e kesaj pune.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë **Drejtuesin Teknik / ose me kontrate bashkepunimi** të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë, dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per muajin e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. NENI 8

Argumentimi Ligjor : *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”. Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë që ka të bëjë me Funizim Vendorsje sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Argumentim Teknik per se sherben :

Drejtuesi teknik është përgjegjës përpara investitorit për Rikonstruksionin i rrugeve te brendshme , sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga rendësia e objektit të kontratës, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë),lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë.”, si dhe te të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

Profesioni/Kualifikimi	Numri i te punesuarve
1. Pllakashtrues	3
2. Teknik i mesem ndertimi	1
3. Teknik i mesem Topograf	1
4. Asfaltshtrues	8
5. Elektracist	4

6.	Karpentier	4
7.	Bojaxhi	1
8.	Hekurkthyes	1
9.	Manovrator	2
10.	Shofer	2
11.	Punonjes	19

Për punonjesit eskavatorist/ manovrator/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

a) kontratë individuale të punës;

leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) për shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) për manovratorët/automakinistët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimë dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës. (Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi Ligjor : Kërkesat e mësipërme janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Argumentimi teknik se per se sherbejne stafi teknik si me poshte:

Afati 4 (Kater) muaj.

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $26757:8:88=38.01$ puntore **Nevojiten:**

1-Punonjes te thjeshte nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $13286.8:8:88 = 18.87$ puntore

2-Karpentier nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3066.53:8:88=4.35$ punonjes

2-Elektracist nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte : $1510.34:8:88=4.15$ punonjes

3-Pllakashtruesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $900:8:88=3.07$ punonjes

4-Asfaltoshtrues nevojitet per kryerjen e punimeve ne objekt.. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $5778.55:8:88= 8.2$ puntore

5- Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $484.2:8:132=0.58$ puntore

11-Punonjes sinjalistike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $20:8:88=0.03$ punonjes

12-Operator vijeziimi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit. Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $428:8:88=0.6$ punonjes

2.3.6 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune) , ne liste pagine per muajt e fundit si më poshtë:

- 1 (nje) punonjës me çertifikatë "**Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**"/ **me kontrate bashkepunimi** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.*

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi Ligjor :

- "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" / me kontratë bashkepunimi në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", çdo subjekt punedhënes është i detyruar të ermerojë një punonjes të kualifikuar për mbikqyrjen dhe zbatimin e masave të sigurisë në vendin e punës.

Argumentim Teknik për se duhet siguria e shëndetit në punë:

-Parandalimi i aksidenteve – puna me mjete elektrike, saldim, mund të shkaktojë lëndime serioze.

-Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse – helmëtë, doreza, syze, maska, çizme sigurie për të mbrojtur trupin nga prerjet, djegiet dhe lëndimet e tjera.

2.3.7 Një punësim jo më pak se **45 (dyzete e pese)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi **per muajt e fundit** të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për **muajt** e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi Ligjor : Kriteri i vendosur për disponimin e numrit minimal prej **45 (dyzete e pese)** punonjës, për të paktën e fundit, është në zbatim të nenit 77 pika 4 e LPP-se dhe nenit 39 pika 6/c, ku numri i punonjesve i kërkuar është në përputhje me permasat dhe specifikat e kontratës. Në përlogaritjen e numrit të punonjesve, njesia e prokurorimit ka marrë parasysh numrin e punonjesve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, ku në zbatim të nenit 77 pika 5 të LPP-se dhe

legjislaconin tatimor, jane percaktuar dokumentet konkrete qe duhen te paraqiten nga operoret ekonomike pjesemarres, per permbushjen e ketyre kushteve. Ne perllogaritjen e numrit te punonjesve perfshihen punonjesit inxiniere, specialiste, punonjes te kualifikuar dhe punetore per punime me krah, drejtuesit e mjeteve te thjeshta dhe te renda etj., duke pasur parasysh njekohesisht volumin e larte te punimeve.

Gjithashtu per te vertetuar zoterimin e fuqise punetore si dhe stabilitetin e saj eshte duke kerkuar edhe vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore si dhe ne listepagesat e punonjesve mbeshetur edhe ne Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 te VKM Nr 285, date 19.05.2021 *Per miratimin e rregullave te prokurorimit publik* dhe sipas te ciles: *Autoriteti/enti kontraktor , pervec kerkesave te parashikuara ne kete nen, mund te percaktoj kriteret e tjera te vecanta, ne varesi te objektit qe prokurohet, te cilat i vlereson te nnevojshme per ekzekutimin me sukses te kontrates.*

Argumentimi Teknik se per se duhet nr i punonjesve

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlloritur si më poshtë:

Numri i punonjesve 45 (dyzet e pese)

Afati 4 (Kater) muaj.

Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte $26757:8:88=38.01$ puntore

Nevojiten:

1-Punonjes te thjeshte nevojitet per kryerjen e punimeve te ndryshme te ndertimit. Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $13286.8:8:88 = 18.87$ puntore

2-Karpiertier nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $3066.53:8:88=4.35$ punonjes

2-Elektracist nevojitet per kryerjen e punimeve elektrike.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte : $1510.34:8:88=4.15$ punonjes

3-Pllakashtruesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $900:8:88=3.07$ punonjes

4-Asfaltoshtrues nevojitet per kryerjen e punimeve ne objekt..Sasia e oreve te punes sipas manualit është: $5778.55:8:88= 8.2$ puntore

5- Hekurkthyesi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $484.2:8:132=0.58$ puntore

11-Punonjes sinjalistike nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte: $20:8:88=0.03$ punonjes

12-Operator vijeziimi nevojitet per kryerjen e punimeve sipas zerave te preventivit.Sasia e oreve te punes sipas manualit eshte:428:8:88=0.6 punonjes

Shofer 2(dy) punonjes –

Manovrator 2(dy) punonjes –

Inxhinierat 3 (tre)

Shenim:Ne momentin e vleresimit dhe shqyrtimit te kriterve klasifikuese ky kriter do te konsiderohet i permbushur me dorezimin e vetdeklarimit permbledhes sipas Shtojces 8, bazuar ne nenin 82 te Ligjit Nr. 162/2020 Per prokurimin publik si dhe ne germen dh) te pikes 2 te nenit 26 te Vendimit nr.285 date 19.05.2021 te Keshillit te Ministrave Per miratimin e rregullave te prokurorimit publik, i ndryshuar.

2.3.8 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr.	Emri i mjetit/pajisjes	Sasia	Statusi
	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	2 copë	në pronësi ose me qera
	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	1 copë	në pronësi ose me qera
	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 2 ton	2 copë	në pronësi ose me qera
	Kamion pajisur me vinç	1 copë	në pronësi ose me qera
	Eskavator me zinxhire	1 cope	në pronësi ose me qera
	Buldozer	1 copë	në pronësi ose me qera
	Eskavator me goma – Mjet Teknologjik me Goma	2 copë	në pronësi ose me qera
	Fadrome/Skrep Mjet Teknologjik me Goma	1 copë	në pronësi ose me qera
	Minieskavatore	1 copë	në pronësi ose me qera
	Rul Gome Cilinder 2-6 ton asfalti	1 copë	në pronësi ose me qera
	Rrul cilinder-cilinder 6-8 ton asfalti	1 copë	në pronësi ose me qera
	Rrul Gomë-Gomë mbi 7 ton	1 copë	në pronësi ose me qera
	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	1 copë	në pronësi ose me qera
	Autobetoniere	4 cope	në pronësi ose me qera
	Autopompe betoni	2 copë	në pronësi ose me qera
	Sharre/prerese asfalti	1 copë	në pronësi ose me qera
	Tranxhe/sharre hekuri	1 copë	në pronësi ose me qera
	Makineri/Fshese Asfalti	1 cope	në pronësi ose me qera
	Asfaltoshtruese	2 copë	në pronësi ose me qera
	Autobitumatriçe	2 copë	në pronësi ose me qera
	Autobot uji	1 copë	në pronësi ose me qera
	Pompa uji	2 copë	në pronësi ose me qera

	Bob Cat ose ekuivalent	2 copë	në pronësi ose me qera
	Depozita Uji 2000 litra	2 copë	në pronësi ose me qera
	Armature dërrase	200 m2	në pronësi ose me qera
	Matrapik	1 copë	në pronësi ose me qera
	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	40 copë	në pronësi ose me qera
	Fikse zjarri	5 copë	në pronësi ose me qera
	Jeleke Pune	45 copë	në pronësi ose me qera
	Prozhektore ndricimi	5 copë	në pronësi ose me qera
	Kompresor	2 copë	në pronësi ose me qera
	Gjenerator minimumi 50KVA	1 copë	në pronësi ose me qera

Operatori ekonomik duhet të paraqese dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës si më poshtë ;

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet:

- a) **Dokumenti që vërteton pronësinë (çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor);**
- b) **Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);**
- c) **Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)**
- d) **Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;**
- e) **Çertifikatë transporti nga njësia vendore;**
- f) **Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij**

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë me qira, duhet të paraqitet:

- a) **Kontrata e qerasë**
- b) **Dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi);**
- c) **Çertifikatën e vlefshmërisë së kontrollit teknik (SGS)**
- d) **Siguracion (polica e sigurimit) i vlefshëm i mjetit;**
- e) **Çertifikatë transporti nga njësia vendore;**
- f) **Foto të mjetit ku të dallohen qartë të dhënat specifike të tij**

- Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë duhet të paraqiten dokumenta që vërtetojnë pronësinë apo marrjen me qira të tyre (fatura tatimore blerje, akte ç'doganimi, kontrata noteriale për marrjen me qira)

- Për mjetet e transportit për mallrat të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqesin çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).

- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendodhjen e mjeteve, me qëllim verifikimi në çdo kohë prej Autoritetit Kontraktor deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës së makinerive.

- Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM – së Nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, bazuar në zërat e preventivit të punimeve.

- Mjetet e tjera që kërkohen i referohen sigurisë dhe shëndetit në kantier. Numri i kërkuar për secilin nga këto mjete i referohet numrit të personelit të kërkuar.

Numri dhe lloji i makinerive, pajisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standartave, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentat konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet oraganizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit.

Nr.	Emri i mjetit/pajisjes	Sasia	Argumentimi
	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 30 ton	2 copë	<p>Per realizimin e transportit te asfaltit ne kantier ne kuader te realizmit te zerave: “Shtrese binderi me granil gur kave,6cm,me makineri. Dhe “Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri”.</p> <p>Keto zera punimesh perfshijne transportin ne kantier, shtrimin dhe ngjeshjen e duhur te asfaltobetoni te ngrohte te perzieries ne shtresen e percaktuar ne Projekt. Sipas Preventivit jane parashikuar Asfaltobetone konvertuar ne ton, rreth 1120 ton (binder+tapet), ne referim te e rregullave teknike të projektimit dhe ndërtimit të rrugëve...specifikimet”, midis të tjerave parashikon se: përzierja e prodhuar duhet të transportohet menjëherë në kantierin e ndërtimit. Sa me siper, duke marre parasysh sasite e kerkuara, procesin teknik te furnizimit, dhe ai i vendosjes, si dhe ne kushtet kur nuk jane mallra qe mund te rrine ne gjendje magazinimi, nga vet natyra fizike e tyre (binder/asfaltobetone), por menjehere pas procesit te prodhimit ngakohen ne mjet, dhe dergohen ne vendin e vendosjes ne veper per volumin 1120 ton asfalt (binder+tapet) duhet te kryhen rreth 38 rruge me kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes 30 ton. Ne kushtet qe shtresat e asfaltit realizohen ne procedure te vecante duke ndjekur furnizimin e panderprere i grupit te shtrimit dhe te asfaltoshtrueses me material si dhe furnizimin ne temperaturat e KTZ, do duhen te paktën 2 kamiona 30 ton qe te operojne ne forme stafete, per te patur nje realizim korrekt dhe ne kohen e duhur te shtresave pa vonesa dhe ruajtjen e temperatures se mases se asfaltobetoni i cili mbas shkarkimit nga perzieresi duhet te jete ne kufijte 140 deri 160°C. Kur temperatura e mjedisit te jashtem eshte 5 deri ne 10°C, kufiri me i ulet i asfaltobetoni do te jete jo me pak se 150°C (STASH 660-87).</p>
	Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	3 copë	<p>Per realizimin e zerit : An.2.37/5a Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0km> Sasia = 8545 m3x 1.7ton/m3(koef.Inert) = 14527 ton rezulton: 14527 ton/20 ton/rrugë = 726 rrugë. Ngarkimi ne mjet 30 minuta (pa vonesa) Rruga 5 km = 15 minuta (pa vonesa) Shkarkimi ne vendgrumbullim = 10 minuta (pa vonesa) Kthimi Bosh = 15 Minuta (pa vonesa) Koha totale e zerit Transport per nje mjet 20 Ton = 70 minuta</p>
	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri 2 ton	2 copë	Kamioncinat per aftesine e tyre te operimit, jane te nevojshme per transportimin e mjeteve te punes, te sigurimit teknik, materialeve dhe paisjeve relativisht te lehta, etj
	Kamionçina me kapacitet mbajtës 2 deri 4 ton	2 copë	Kamioncinat per aftesine e tyre te operimit, jane te nevojshme per transportimin e tubove plastike, kapakeve te pusetave, materialet elektrike etj.
	Kamion pajisur me vinç	2 copë	Kamion pajisur me vinç te nevojshem per transport dhe vendosje ne objekt te zerave: Tuba betoni Ø 1200>=15 ml, Tuba te brinjzuar HDPE SN8 d=315mm=1050 ml dhe

			ngarkime apo shkarkime te materialeve hekur, cimento, kapak gize konstruksione metalike etj.
	Eskavator me zinxhire	1 cope	Per realizimin e zerit "Germim kanali KUB-se , ekskavator me zinxhir 0.5m3" me sasi 300 m3
	Buldozer	1 copë	Hapje traseje e aksit te rruges, sistemime para realizimit te shtresave per mbi 12900 m2.
	Eskavator me goma – Mjet Teknologjik me Goma	2 copë	Per realizimin e Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet > me sasi rreth 2000 m3.
	Fadrome/Skrep Mjet Teknologjik me Goma	2 copë	Per realizimin e zerave gropa shtyllash, mbushje me cakull dhe zhavorr pas mureve mbi 310 m3
	Minieskavatore	2 copë	Per realizimin e mbushjeve dhe mbulimit te kanaleve te drenazhimit Tuba betoni Ø 1200>=15 ml, Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315mm=1050 ml, etj.
	Eskavator pajisur me çekiq dhe pincë	1 copë	Per realizimin e zerave prishje trotuari, prishje soleta betoni, prishje kollona trare betonarme etj.
	Rul Gome Cilinder 2-6 ton asfalti	2 copë	Per realizimin e ngejshjes Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri rreth 14 mije m2, ku duhet te realizohen te pakten 2 kalime mbi siperfaqen e shtruar.
	Rrul cilinder-cilinder 6-8 ton asfalti	2 copë	Per realizimin e ngejshjes Shtrese asfaltbetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri rreth 14 mije m2, ku duhet te realizohen te pakten 2 kalime mbi siperfaqen e shtruar.
	Rrul Gomë-Gomë mbi 7 ton	2 copë	Per realizimin e ngjeshjes finale te tapetit/asfaltbetonit rreth 14 mije m2, ku duhet te realizohen te pakten 4 kalime mbi siperfaqen e shtruar.
	Rrul ngjeshes me vibrim deri 5 ton	2 copë	Per ngjeshjen e trasese se kasonetes se rruges. Ngjeshja do te behet me rula vibrues duke e lagur me uje. Te pakten 4 kalime.
	Autobetoniere	4 cope	Per furnizimin me beton ne kantier per realizimin e zerave te betonit rreth 641 m3 betone.
	Autopompe betoni	2 copë	Per hedhjen ne objekt te zerave te betoni ne veper.
	Sharre/prerese asfalti	1 copë	Per nevojat e prerjes se shtresave asfaltike ne objekt
	Tranxhe/sharre hekuri	1 copë	Per prerje dhe perthyrje te hekurit sipas zerave perkates te preventivit ne objekt.
	Makineri/Fshese Asfalti	1 cope	Per sistemim pastimim te siperfaqeve te shtruara me asfalt.
	Asfaltoshtruese	2 copë	Per realziimin e shtresave asfaltike ne veper sipas zerave te preventivit per rreth 14 m2 shtresa asfalti.
	Autobitumatriçe	2 copë	Per sjelljen ne veper te emulsionit te bitumit mbi 14 mije kg, hedhjes dhe shperhapjen e tij ne trajten e lëngut te nxehte.
	Autobot uji	1 copë	Per nevojat me uje gjate punimeve, gjate shtresave te cakullit dhe stabilizantit.
	Pompa uji	2 copë	Per nevoja thithje te ujerave siperfaqesor, ne kanale etj.
	Bob Cat ose ekuivalent	2 copë	Per punime te vogla rrugore.
	Depozita Uji 2000 litra	2 copë	Te shperndara ne gjatesine e aksit per nevojat ndertimore.
	Armature dërrase	200 m2	Per kallepe te pusetave dhe kunetave, ura etj
	Matrapik	1 copë	Mjet ndihmes per realizimin e punimeve te prishjeve
	Tabela sinjalistike sigurimi teknik	40 copë	Per rregullat e sigurimit teknik dhe drejtimit te levizjes.
	Fikse zjarri	5 copë	Per nevoja emergjente ne kushtet kur kemi perdorim te mjeteve makinerive, lendes djegese, emulsionit te bitumit, asfaltit etj. Ne qendra te banuara
	Jeke Pune	45 copë	Veshje ne kuader te rregullave te sigurimit teknik

	Prozhektore ndricimi	5 copë	Per nevojat e sigurise teknike ne erresire, kryerjes se punimeve emergjente apo perfundimit te proceseve te cilet nuk mund te nderpriten pavaresisht nivelit te ndricimit natyror.
	Kompresor	2 copë	Per nevojat e realizimit te punimeve te ndertimit, perdorimin e matrapikeve cekiceve pneumatike etj
	Gjenerator minimumi 50KVA	1 copë	Per nevojat me energji elektrike te pavarur nga rrjeti lokal.

1. Autovetëshkarkuese dhe mjete transporti

Përdoren për transportin e dheut nga gërmimet, materialeve nga prishjet dhe furnizimin me agregate, çakëll dhe materiale ndërtimi. Këto mjete sigurojnë vijueshmërinë e punimeve dhe shmangien e ndërprerjeve gjatë ciklit ngarkim–transport–shkarkim.

2. Kamion me kapacitet mbi 20 ton dhe mbi 30 ton

Përdoren për transport të materialeve në volume të mëdha si asfalt, inerte dhe elementë betoni, duke optimizuar kohën dhe numrin e cikleve të transportit.

3. Ekskavator (me goma dhe me zinxhir)

Përdoret në punimet e gërmimit për trup rruge, kanale KUB dhe themele. Siguron efikasitet të lartë dhe saktësi në realizimin e seksioneve sipas projektit.

4. Minieskavator dhe Bobcat

Përdoren për punime në hapësira të kufizuara dhe për ndërhyrje precize, veçanërisht në rrjete dhe zona urbane.

5. Rul kompaktor cilindrik dhe rul gomë-gomë

Përdoren për ngjeshjen e shtresave rrugore dhe asfaltike. Ruli cilindrik siguron kompaktim bazë, ndërsa ruli gomë-gomë përfundimin dhe densitet optimal.

6. Asfaltoshtruese

Përdoret për shtrimin e shtresave asfaltike në mënyrë uniforme dhe sipas trashësisë së kërkuar në projekt.

7. Autobitumatrice

Përdoret për aplikimin e bitumit dhe lidhjen ndërmjet shtresave rrugore.

8. Autobot uji

Përdoret për lagjen e sipërfaqeve, kontrollin e pluhurit dhe përgatitjen e shtresave për kompaktim.

9. Autobetoniera dhe Autopompë betoni

Autobetoniera përdoret për transportin e betonit, ndërsa autopompa për hedhjen e tij në elementë strukturorë dhe zona të vështira për akses.

10. Vinc dhe Autovinç

Përdoren për ngritjen dhe vendosjen e elementëve të rëndë si tubacione dhe struktura metalike.

11. Kompresor dhe pajisje spërkatëse

Përdoren për furnizimin me ajër dhe për aplikimin e bojës në sinjalistikë.

12. Sharrë prerëse asfalti

Përdoret për prerjen e shtresave asfaltike gjatë ndërhyrjeve dhe riparimeve.

13. Sharrë hekuri / tranxhë

Përdoret për prerjen e elementëve metalikë dhe strukturorë gjatë montimeve.

Konkluzion: Përdorimi i makinerive është përcaktuar në përputhje të plotë me analizat e zërave të preventivit dhe grafikun e punimeve. Nuk janë përfshirë pajisje të panevojshme, duke garantuar një organizim teknik të saktë, racional dhe të mbrojtur të procesit të ndërtimit.

Argumentimi i specifikimeve teknike : *Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.*

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.